



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

L ë n d a: Mbledhja e Komisionit Kombëtar të Nomenklaturave

KKN

Minutat e takimit

Datë 12.12.2019

Më datë 12 Dhjetor u mbajt takimi i dytë për vitin 2019 i Komisionit Kombëtar për Nomenklaturat. Drejtori i komanduar i INSTAT, Znj. Elsa Dhuli, përshëndeti anëtarët e KKN-së. Më tej Znj. Dhuli prezantoi agjendën takimit, e cila u pranua nga të gjithë pjesëmarrësit në mbledhje.

Në mbledhjen e radhës së KKN-së u diskutua:

1. Raportim nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale mbi ecurinë e trajnimeve për zbatimin e klasifikimit ndërkombëtar të sëmundjeve, ICD-10, nga sistemi shëndetësor.

Përfaqësuesja e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Znj. Merita Xhafa bëri një raportim të situatës mbi ecurinë e trajnimeve për zbatimin e klasifikimit ndërkombëtar të sëmundjeve ICD-10, trajnim i ndërmarrë nga sistemi shëndetësor. Ndër të tjera Znj. Xhafa shpjegoi që trajnimi ka filluar me një financim modest nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, OBSH.

2. Prezantim nga INSTAT mbi iniciativën për zbatimin e Nomenklaturës Ndërkombëtare të krimeve për qëllime Statistikore (ICCS)

Znj Dhuli bëri një prezantim të nomenklaturës ndërkombëtare të krimeve. INSTAT e ka filluar këtë punë prej disa kohësh. Është përgatitur kapitulli i parë i këtij klasifikimi. Më tej anëtarët e komisionit u informuan për takimin me grupin e punës që është organizuar në INSTAT. Institucionet përfshirëse të grupit të punës janë: Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Ky klasifikim përbën një rëndësi shumë të madhe pasi do të sigurojë një strukturë të përbashkët për prodhimin e statistikave të krimeve dhe të drejtësisë penale në të gjitha institucionet e

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta", Nd.35, H.1 Tiranë, ALBANIA,

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

drejtësisë penale, strukturë kjo që sot nuk është. Ky klasifikim do të ofrojë gjithashtu analiza analitike për të dhënat statistikore, do të ofrojë mbështetje për hartimin e politikave etj. Ky klasifikim bazohet në katër nivele kryesore, niveli i parë është dhe niveli më i madh i cili përmban 11 kapituj. Për zbatimin e kësaj nomenklature, INSTAT ka ngritur një grup pune i cili u permend me lartë nga Znj Dhuli. Ky klasifikim është i vështirë për tu implementuar. Disa nga anëtarët e KKN-së shprehën interesin e tyre për të qenë pjesë e mbledhjeve të grupit të punës për këtë klasifikim.

3. Raportim nga Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë mbi procesin e rishikimit të ISCED

Klasifikimi i Arsimit ka qenë në agjendën e disa takimeve të KKN. Znj Dikensa Gjokutaj, Drejtoreshë në MASR raportoi mbi këtë klasifikim.

ISCED 2011 paraqet një rishikim të niveleve të klasifikimit të arsimit të ISCED 1997. Zbatimi i ISCED 2011 është një detyrim si shtet anëtar i UNESCO dhe detyrim në kuadër të përafrimit të Acquis Communautaire

MASR ka përcjellë për mendime tek Institucionet e Arsimit të Lartë ISCED. Sugjerimet dhe komentet e tyre janë dërguar edhe në INSTAT.

4. Raportim mbi ecurinë e trajnimeve mbi zbatimin e klasifikimeve:

- **Nomenklatura e statistikave të transportit, NST-2007**

Në trajnimin e NST 2007, morën pjesë institucionet në varësi të MIE të cilat raportojnë të dhënat e mallrave të transportuara sipas llojeve të Transportit, të cilat ishin si më poshtë:

1. Përfaqësuesit e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE),
2. Përfaqësuesit e Autoritetit Portual Durrës,
3. Përfaqësuesit Portit Vlorë,
4. Përfaqësuesit e Portit Sarandë
5. Përfaqësuesit e Portit Shëngjin.

- **Nomenklatura e klasifikimit të llojeve të ndërtimit (KN)**

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta", Nd.35, H.1 Tiranë, ALBANIA,

Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

www.instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Trajnimit për zbatimin i “Nomenklaturës së Llojeve të Ndërtimit (KN) u zhvillua në korrik 2019. Pjesëmarrës në trajnim ishte stafi i Zyrave Rajonale Statistikore, të cilët do të mbështesin stafin e bashkive.

Përgatiti:
Sekretariati i KKN

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta”, Nd.35, H.1 Tiranë, ALBANIA,

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al